

## Bisedë me bashkëpunëtorët

Intervistë me Dr. Astrit Beci, Drejtor i OSHKSH Shkodër

### Dr. Beci, a mund të na përshkruani shkurtimisht Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor?

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, u krijua në kuadër të reformave të qeverisjes në sektorin e shëndetësisë. Struktura organizative e tij përbëhet nga një drejtori kombëtare dhe katër drejtori rajonale me seli në Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Elbasan.

Qëllimi i krijimit të Operatorit është menaxhimi i shërbimit kujdesit parësor dhe spitalor nga një institucion i vetëm, duke garantuar ofrimin e plotë të këtyre shërbimeve në nivel rajonal dhe organizimin në mënyrë efikase të burimeve njerëzore e financiare, të aseteve dhe materialeve.



### A ka sjellë ndryshime në punën e OSHKSH Shkodër bashkëpunimi me HAP? Nëse po, mund të na tregoni disa shembuj konkret?

Bashkëpunimi me HAP-in krijoi një qasje të re për të gjithë ekipin e drejtorisë tonë në drejtim të, qartësisht të rolit të Operatorit që i shërbeu një procesi planifikimi strategjik përfshirë resurseve financiare, shkencore etj (organizimi i tavolinave të rrumbullakta, seminareve, konferencave dhe trajnimit të personelit shëndetësor parësor dhe spitalor dhe qasjen e ndërtimit të urave të bashkëpunimit ndërsektorial). Një aspekt i rëndësishëm ka qenë pajisja me logjistike të teknologjisë së informacionit nga HAP pasi ka lehtësuar maksimalisht punën në mirëmenaxhimin e informacionit të grumbulluar, raportimin në kohë dhe realizimin e detyrave në afatet e përcaktuara.

Gjithashtu, trajnimi i ofruar nga HAP për punonjësit e OSHKSH-së zgjeroi njohuritë rreth mënyrës së përpunimit statistikor të të dhënave dhe marrjes së një feedback-u sa më real me qëllim planifikimin e nevojës për ndërhyrje në shërbimet specifike (parësor, spitalor, shëndet publik.) Së fundi, mundësia nga HAP me mjet transporti për nevojat funksionale ka përmirësuar ndjeshëm aksesimin e të gjitha pikave territoriale që ne mbulojmë. Rëndësia e automjetit dhe efikasitetit i tij u panë në ballafaqimin me situatën post tërmet dhe problematikat në pandeminë COVID-19.

## Cilat fusha bashkëpunimi me HAP mund t'i konsideroni si përparësi për të ardhmen?

Që prej fillimit të këtij institucioni, HAP ka mbështetur dhe ndihmuar në realizimin e funksioneve specifike duke ofruar asistencë në zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale të përgjithshme, raportimin, grumbullimin e informacionit dhe analizimin e të dhënave në nivel rajonal me qëllim njohjen e situatës dhe përgatitjen e një plani adekuat ndërhyrjeje; ngritjen e sistemit të mbikqyrjes mbështetëse për shërbimet e KSHP-së si edhe mbështetjen e kapaciteteve monitoruese për cilësinë e sistemit/shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Në vijimësi, mund të them që kemi shumë sfida për realizimin e misionit për të cilin ky institucion u krijua ndaj vlerësoj që bashkëpunimi me HAP do të ketë një rëndësi të madhe pasi deri më tani shumë gjëra kanë ngelur të shkruara vetëm në letër. Institucioni ka nevojë për më shumë kompetenca në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe vendimmarrjes për menaxhimin e burimeve financiare. Në këtë drejtim, mendoj që duhen ndarë më mirë ose rritur më shumë kompetencat në raport me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo do të shërbejë për të qartësuar të gjithë aktorët në mënyrë që të kuptojnë delegimin e kompetencave, rritjen e autonomisë së institucioneve, për demokratizimin dhe forcimin e tyre.

Gjithashtu, është e rëndësishme që të rriten kapacitetet e OSHKSH për: forcimin e autonomisë së qendrave shëndetësore (duke planifikuar një bashkëpunim më të mirë me FSDKSH), vënien në dispozicion dhe zbatimin e protokolleve në të gjitha institucionet shëndetësore, rritjen e cilësisë së shërbimeve (përmes akreditimit të institucioneve, rritjes së transparencës institucionale etj).

Sa më sipër, mendoj që bashkëpunimi me HAP në të ardhmen të fokusohet në fushat e përmendura më lart duke pasur si qëllim final përmbushjen e misionit të Operatorit.

